



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izbori Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.565/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri – Kryesues dhe Ferki Xhaferi e Burim Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Rexhë Qestaj, me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.565/2021 i paraqitur nga Rexhë Qestaj, me vendbanim në Zvicër, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 30.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Rexhë Qestaj me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se i është refuzuar aplikimi nga KQZ për arsye të njëjta si i është refuzuar edhe Ukë Qestaj- familjarit të tij. Në apelin e parashtruar nga Ukë Qestaj pretendohet se KQZ ka bërë shkelje duke e eliminuar atë dhe familjen me arsye kemi dërguar aplikacionet nga emaili njëjtë. Sipas tij në pamundësi që të aplikojnë personalisht kanë autorizuar familjarin përkatësisht axhin e tyre Isuf Qestaj që të aplikojë për tërë familjen nga emaili isuf_kestaj@outlook.com, andaj edhe i është refuzuar aplikimi.

Parashtruesi i apelit, apelit i ka bashkangjitur emailin nga KQZ, formularët e aplikimit si dhe dokumentin identifikues/ letërnjoftimin

Me datë 30.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 31.08.2021 në ora 17:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se lidhur me këtë apel të parashtruar nga Rexhë Qestaj është bërë aplikim nga emali i isuf_kestaj@outlook.com, ku janë pranuar gjithsej 14 aplikacione për regjistrim edhe pse me mbiemër të njëjtë këto aplikacione i përkasin aplikuesve që për vendbanim kanë tri shtete të ndryshme si Zvicër, Gjermani dhe Suedi. Sipas kësaj përgjigje të gjithë personat me mbiemër Qestaj nuk cilësohen si rreth i ngushtë familjar për shkak se duke përfshirë edhe ankuesit dhe personat tjerë që kanë vendbanim në Gjermani dhe Suedi, aplikacionet të të cilëve janë dërguar nga po e njëjta email nuk janë cilësuar si rreth i ngushtë familjar për arsye se për vendbanim kanë shtete të ndryshme dhe për këtë arsye duhet refuzuar të gjithë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit Rexhë Qestaj gjatë periudhës për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës ka bërë aplikim për regjistrim përmes axhës së tij Isuf Qestaj dhe i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi me të cilin e vërteton faktin se axha i tij Isuf Qestaj ka pasur autorizim siç pretendon në apelin e tij për të aplikuar në emër të apeluesit. Paneli gjithashtu ka konstatuar se edhe pse aplikimi është bërë për persona me mbiemër të njëjtë dhe që kanë vendbanim të njëjtë kjo nuk e vërteton faktin se të njëjtit janë rreth i ngushtë familjar pasi që në rastin konkret nuk është ofruar asnjë provë që dëshmon se të njëjtit janë në rrethin e ngushtë familjare siç përcaktohet në nenin 2 paragrafi 2.1 të udhëzimit administrativ nr. 02/2021, andaj edhe emri i tij nuk figuron në bazën e të dhënave të KQZ-së për votuesit jashtë Kosovës, meqenëse nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: **“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”**, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”** dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

- a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,*
- b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle.*

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura si më larte, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret ankuesi thëniet e tij nuk i mbështetën në asnjë provë konkrete por se të njëjtat janë supozime dhe se këto pretendime ankuesi nuk i argumenton me asnjë provë.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtruar nga Rexhë Qestaj nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e pretenduar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 565/2021 më datën 01.09.2021



Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.